



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al), Tel: +35522400150

**PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN**

**PËR**

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË  
BASHKISË SHKODËR”.**

**Konsultim publik :** *Banorët e Nj. Administrative Velipojë.*

**Data :** 07.10.2022

**Ora :** 13.00

**Vendi:** *Pranë Njesisë Administrative Velipojë*

**Numri i pjesëmarrësve :** *Numri i pjesëmarrësve 25, nga të cilat 4 gra dhe vajza.*

**Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :** *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

**Pjesëmarrës :** Drejtues dhe specialiste të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

**Takimi bashkë-drejtohet nga Zv. Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:**

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

**Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon:**

Hapja konsultimit nga ZV/Kryetari i Bashkisë z.Tonin Dedaj, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

Ai falenderon për pjesëmarrjen në këtë takim për projekt propozimet për vitin 2023 – 2025 duke theksuar rëndësinë e mendimeve dhe prozimeve për të arritur që të planifikojmë investimet dhe shërbimet për vitin e ardhshëm. Për ne është me shumë rëndësi edhe pjesëmarrja e Këshillit Bashkiak në këto takime pasi janë ato që miratojnë pastaj edhe projekt buxhetin sipas propozimeve tuaja.

Ne kemi një axhendë për organizimin e diskutimeve ku do të marrim të gjitha funksionet sipas rradhës, duke filluar me:

### **I: ARSIMI PARASHKOLLOR, BAZË, I MESËM I PËRGJITHSHËM, PROFESIONAL**

#### **Z. Altin Kaci, Administrator i Njësisë Velipojë: Prezanton tematikat dhe diskutimet.**

**Blediana Nikaj:-** Ju përshendes të gjithëve, jam normalisht në shtëpinë time këtu dhe pavarësisht situatave dhe problematikave është me rëndësi që të identifikojmë situatat dhe nevojat. Velipoja është pjesa që jep më shumë të ardhura për Bashkinë Shkodër, ndoshta duhet të japim llogari për atë që është përmbushur deri më tani për të parë projektet apo nevojat që kanë mbetur të papërfunduara të parashikohen për buxhetin e vitit tjetër. Të jetë komuniteti një zë i fortë për ato nevoja që ka. Janë dy drejtëza që nuk bashkohen duke filluar me plazhin por edhe me pjesën e fshatit, Velipoja nuk ka të ardhura për frymë sipas kontributit që jep dhe në 21 funksionet që duhet të përmbushë bashkia duhet të ketë një vëmendje më të madhe.

Ne sot këtu nuk jemi për interesin personal për rrugën apo dritën para shtëpisë por për të mirën e përbashkët dhe të jetë Velipoja jo një njësi që vetëm financon me lekë buxhetin por të ketë edhe vëmendje dhe krah i fortë i bashkisë. Ndihem me fat që jam pjesë e këtij komuniteti dhe përfaqësuese e tij në këshill.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Le të fillojmë me propozimet që keni për arsimin dhe cila është situata në shkolla dhe çfarë mendoni se mund të planifikohet për investime dhe shërbime.

**Z. Ferdinand Uka, Fshati Ças:** - Është një shkollë e cila është mbyllur, shkolla Ças për arsye që nuk ka nxënës por mund të ripërdoret dhe të bëhet qendër shëndetësore .

**Zj. Blediana Nika:** - Ajo nuk është aset i Bashkisë Shkodër ka qënë një shtëpi e cila i është dhënë për përdorim si shkollë dhe nuk mund të ndërhyjmë duke mos qënë pronë publike është e vështirë të ndërhyhet.

**Z. Ferdinand Uka:** - Ajo ka qënë dikur kuzhina e fermës dhe gjithsesi është publike.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Do ta mbajmë parasysh që të identifikohet dhe nëse është publike do të ndërhyjmë sipas propozimit tuaj.

## **II Menaxhimi dhe pastrimi i mbetjeve.**

**Z. Kolë Çokaj banor i fshatit Rrjoll** - Ne nuk kemi as kosha as pastrim, të gjitha i mbledhim pranë shtëpive tona. Gjendja është shumë e keqe.

Kam një vit që kam mbaruar akt marrëveshjen për sa i përket dritave. Kam paguar deri me tani dhe vijoj të gjej gjoba dhe pagesa për shpenzim energjie që nuk e kam bërë sepse banoj në Itali kam shumë problem me këtë pjesë (ndoshta nuk është juridiksion i juaji), kam bërë pagesat sepse kështu kërkohet për të hapur procedurë gjyqi por asgjë s'kam zgjidhur deri tani.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj :** - Bashkia nuk ka juridiksion në këtë pjesë dhe e vetmja mënyrë zgjidhje për ju është kujdesi i klientit dhe gjykata. Ndërsa në lidhje me problemet e pastrimit do i kemi në vëmendje.

**Banor i fshatit Rrjoll :** - Sa është numri i nxënësve për të pasur një shkollë sepse në Rrjoll ne nuk kemi shkollë.

**Zj. Blediana Nika :** - Kjo përcaktohet me VKM dhe kam kërkuar që shkolla të kalojë në administrim të shkollës Velipojë sikur edhe një nxënës të jetë ne e kemi të mundur të rrijë e hapur.

Kjo shkollë nuk funksionon dhe ne duam ta mbyllim sepse ka 5 mësues dhe 4 fëmijë dhe po të mbyllet kjo shkollë kostot e mësuesve do të kalonin tek ne dhe banorët. Duke qenë se shkolla është e hapur atje ne nuk marrim përfitim sepse na thuhet që duhet të shkojnë në shkollën e Rrjollit. Pagesa maksimale që përfitohet është një procedurë shumë e gjatë dhe për të ardhurat deri në 1 000 lek që merrni nuk besoj që ka vlerë. Kjo është e pamundur edhe nga ana procedurale dhe do të krijojë shumë problem. Bashkia së bashku me ZVA e kanë të pamundur që ta mbyllin shkollën. Ne mendojmë në favor dhe për fëmijët dhe do ta shohim këtë pjesë me shumë prioritet.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - A mundemi ne që të diskutojmë me ZVA që të krijojnë kushte të mira mësimdhëniet për shkollën e Rrjollit duke i shërbyer edhe kësaj shkolle ?

Megjithëse numri i banorëve është vetëm në rënie dhe nuk ka vlerë.

## **III Ndriçimi dhe gjelbërimi.**

**Z. Kolë Ftoi banor i fshatit Rrjoll:** - Në Pulaj Plazh kemi gjelbërim, problem kemi gjelbërimin në fshatin Rrjoll, është e nevojshme që të kemi vëmendje për këtë pjesë të gjelbërimit në fshatin Rrjoll aq më tepër që tani po mbaron edhe rruga.

**Z. Ferdinand Uka – Ças:** - Kemi nevojë që të kemi ndriçim dhe asfaltim për fshatin Ças për disa pjesë që nuk janë përfunduar.

Ndriçim ka nevojë edhe brenda lagjes Gomsiqe ku janë bërë rrugët.

Edhe ndriçimi përpara njësisë ka nevojë për të nderhyrje dhe duhen ndërruar llampat.

Reçi i ri ka nevojë gjithashtu për ndriçim po ashtu edhe në Velipojë sektor ka shumë nevojë.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z.Tonin Dedaj :** - Ne do të mundohemi të prioritarizojmë këto investime qoftë për ndriçimin apo për të tjera ndërhyrje që do të realizohen gradualisht sidomos në zonat e banuara ku nevoja për ndriçim është jetike.

#### **IV. Menaxhimi i ujitjes dhe shërbimet bujqësore.**

**Z. Ferdinand Uka fshati Ças:** - Kanalet e kullimit, kanale të dyta që ka bashkia duhet të kalojnë tek bordi i kullimi I dhe II dhe ka 300 hektarë në shërbim pasi kemi shumë problem nga kanali sepse n'a shkon dëm i gjithë prodhimi.

**Z. Alban Sekja Drejtor Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AMTP-ve:** - Kanalet e dyta të fushës së Çasit janë të vështira për të ndërhyrë në to nga ana jonë, Velipoja është e veçantë në këtë pjesë dhe duhet medeomos ndërhyrja nga Bordi i Kullimit.

**Zj. Blediana Nika:** - A funksionon ideja e marrëveshjes me Bordin e Kullimit për të bashkëpunuar për këtë pjesë?

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Po kanal të parë a ka ?

**Z. Alban Sekja Drejtor Drejtorja e Bujqësisë,Zhvillimit Rural dhe AMTP-ve:** - Po ka dhe është shumë i madh, do të komunikojmë sërish me Drejtorin e Bordit të Kullimit në Lezhë.

**Z. Ferdinand Uka fshati Ças:** - Ujërat e zeza, janë bllokuar tubacionet në rrugën ku është bërë dhe ka nevojë të zhblllokohet tubacioni shkarkues.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Atë me patjetër do e realizojmë.

**Zj. Blediana Nika:** - Janë vite e vite investim nga i gjithë komuniteti dhe është një mundësi e mirë që të zgjidhen brenda mundësive dhe nuk kemi pasur pengesë për këtë.

**Z. Ndok Sokoli banor i fshatit Baks:** - Sa herë mblidhemi diskutojmë për këtë pjesë, në Baks kemi problem pemët që kanë bllokuar kanalet e dyta e të treta pasi është zonë që përmytet dhe nqs nuk kullohen e pastrohen këto kanale. Mjafton një fadromë për të realizuar këte ndërhyrje.

Për një trotuar dhe ndriçim kemi nevojë në Baks të Ri.

**Zj. Blediana Nika:** - E kemi planifikuar që në buxhetin e vjetshëm për realizim në këtë vit.

## **V. Rrugët dhe infrastruktura.**

**Z. Ndok Sokoli banor i fshatit Baks:** - Zona e Baksit të Ri është më keq se të gjitha sa i përket rrugëve, nuk janë zbatuar asnjëra për të cilat është folur më përpara këtu.

**Zj. Blediana Nika:** - Është goxha problem ajo pjesë sepse numri i popullsisë prioritarizon edhe investimet.

**Banor i fshatit Rrjoll:** - Kemi nevojë që të pastrohet rruga kryesore e Rrjollit.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Kjo rrugë është pronë e ARRSH dhe mund të komunikojmë dhe bëjmë presion për pastrim të rrugës nga bimët pasi ne nuk mund të ndërhyjmë.

**Zj. Blediana Nika :** - Duhet që edhe ne banorët të ndërgjegjësohemi për punët që kryejmë në oborret tona të mos i hedhim në koshat e mbetjeve.

**Z. Zef Zefi banor i fshatit Pulaj:** - Këto dy vite është punuar por ne kemi akoma shumë nevoja sidomos tek rruga paralel pedonale, ajo rrugë duhet të zgjerohet sepse ka shumë problem për trafikun. Trotuaret e Velipojës Plazh duhet të përfundohen sepse rruga është bërë por ka nevojë edhe për trotutare.

**Z. Sandër Viluni banor i fshatit Pulaj:** - Rruga e Vilunit është përfunduar dhe falenderojmë bashkinë sepse i vlen edhe banorëve edhe turizmit duke i dhënë vlerë krejt zonës. Për nevojat e problemet e Bashkisë nuk mjafton kurër buxheti por duhet që rrugët që janë për në det të jenë të riparuar. Ka në total tre rrugë kryesore zona e Vilunit dhe duhet të investohen sepse është problematike dhe me rrezik sepse mund edhe të zihen dhe bllokohen.

Për çdo vit kemi turizëm dhe duhet të krijojmë infrastrukturën e nevojshme për të perballuar këtë turizëm.

**Zj. Blediana Nika :** - Sa ka qenë fondi në total për investime? Duhet të kemi një vëmendje shumë të madhe për këtë zonë ,unë normalisht dua më fort njerëzit e mi sesa partitë dhe duhet të japim dhe mbajmë premtimet që i bëjmë banorëve.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj :** - Fakt është sepse ne kemi nje bashki të madhe si nga numri i popullsisë ashtu edhe në shtrirje gjeografike dhe niveli i investimeve është në proporcion me atë që ne mbledhim.

## **VI. UJËSJELLËSI**

**Banor i fshatit Rrjoll :** - Në zonën e Rrjollit nuk vjen uji kurrë gjatë verës , kemi edhe një pjesë ku thjesht është penguar tubacioni dhe kemi nevojë për ndërhyrje nga ana juaj.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Do të sjellim një grup pune për të verifikuar dhe zgjidhur situatën. Me qendrat shendetësore si është situata?

**Z. Gjeto Leka banor i fshatit Mali Kolaj:** - Kemi një qendër të vjetër shendetësore e cila nuk është vënë në punë kurrë, është në Mali Kolaj dhe tanimë kemi nevojë të marrim njëre nga Shkodra për të bërë një injeksion. Kemi nevojë imediate për një infermier.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Kam qenë pjesë e planit të zbatimi dhe qendra nuk është marrë akoma në dorëzim ,do ta verifikojmë këtë situatë dhe të shohim mundësinë për të pasur një infermier aty.

**Banor i fshatit Rrjoll:** - A është e mundur që të jetë dikush që vjen në qendrën shendetësore Rrjoll edhe për gjatë dimrit sepse vjen vetëm në verë.

**Z. Erjon Metushi këshilltar i Këshillit Bashkiak:** - Ku e merrni shërbimin shendetësor ju?

**Banor i fshatit Rrjoll:** - Në qendër Velipojë merret, por duke qenë se ambientet janë duhet të krijohet mundësia që të shkojë infermieri në këtë zonë në shërbim të banorëve.

**Zj. Blediana Nika:** - Të jemi pak më konkret, ne e dimë që ka një rënie të numrit të popullsisë dhe nëq fshati ka shumë pak banorë normalisht infermieri apo mësuesit nuk kanë se si të jenë në shërbim për tre apo 4 fëmijë dhe familje dhe prandaj mbyllën apo transferohen infermierët dhe mësuesit.

**Z. Erjon Metushi këshilltar i Këshillit Bashkiak:** - Mund të lidhen dy fshatra me njëra tjetrin dhe të kenë një qendër të përbashkët.

**Zv. Kryetari i Bashkisë z. Tonin Dedaj:** - Falenderon pjesëmarrësit për opinionet dhe nevojat e paraqitura dhe shpreson që të krijohet mundësia të realizohen këto propozime.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.


**Mbajtësi i Procesverbalit:**

**Bekim Mema**










BASHKIA  
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.  
Nj.Administrative Velipoje

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Nuce	Toke	M	56	Lisoh	ba punë	-
2	Gjeto	Deke	M	70	Mbl Jeshy	-	-
3	Cholok	Lokolaj	M	66	Bok Ri	-	-
4	Zef	Zeha	M	62	Pulq Plozhi	qumtori	-
5	SANDER	VILANI	M	57	BAKS-RRYON	BURR	-
6	Lulzim	Kaq	M	43	Pulaj	-	-
7	Florinot	Nebe	M	58	Geo	Fshetra	-
8	Ridvan	Qevi	M	57	Shkoder	muritor	-
9	<del>Spas Nikoll</del>		M		Edmond	Nikollu	-
10	Spas Nikoll		M	61	Gensiqe	Nenpues Bobki	-
11	Mirë	Ndaj	M	33	Gensiqe	Bryk	-
12	Ardash	Markopi	M	40	Gensiqe	Nenpues Bobki	-
13	Emoh	Çaver	M	84	Perridhet	ri se lloj	-

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA  
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.  
Nj.Administrative Velipoje

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
14	Arben	Gjergji	M	52	Rec	Kryetarëfshkollt	Fermer
15	Arin	Hokë	M	63	Bans: B.	P.2.G. Shurg	hepruc
16	Arben	Vikoll	M	32	60MSiQë	PA POME	-
17	Emilon	Dadi	M	37	Rec i Pi	jurist	U.K. SH.
18	Gjergjit	Pëllumbri	M	56	Trash	Agronom	Bashki Shkodër
19	Yofel	Polari	M	32	Shkodër	Ingjiner Muzri	B. Shkodër
20	OTERGJ	NIKA	M	59	SHKOER	Specialist	B. SHKODËR.
21	Masmina	Gercaku	F	38	Shkodër	Ekonomiste	B. Shkodër
22	Dina	Piraniqi	F	33	Shkodër	Ekonomiste	B. Shkodër
23	Gilbarta Selvia		F	33	Shkodër	Ekonomist	B. Shkodër
24	Regjina	Fusha	F	54	Dajç	Agronomi	NYA Velipoje
25	Armond	PCPQJ	M	30	Regjiri	POLIC	BASHKIA

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK